



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.05.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 13 – 31 maj 2019

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentar Demokrat
Nimet Musa -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Pavarur
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Senida Mesi -	Zëvendëskryetare e Komisionit për Integrimin Europian
Milva Ekonomi -	Zëvendëskryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Klodiana Spahiu -	Zëvendëskryetare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Mungojnë:

Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve për miratimin e kalendarit 3-javor për punimet e Kuvendit.

Arben Ahmetaj – Kryetar, mundem?

Gramoz Ruçi – Po.

Arben Ahmetaj - Para se të fillonte mbledhja iu referova një çështjeje, që e kam porosi rastësore dje, kur u takova me Sekretarin e Përgjithshëm. Ndoshta edhe Lisa duhet ta dijë. Bëhet fjalë për ndryshimin e një akti normativ që ka kërkuar qeveria. Sipas tyre, iu duhet. Besoj se i takon Komisionit të Ekonomisë. Personalisht nuk do ta kisha problem nëse futej në kalendarin 3-javor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta shikoj, sepse ma dërgoi edhe me titull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mbaroj, Taulant.

Taulant Balla – Për procedurë.

Arben Ahmetaj – Dakord, por të mbaroj unë.

Taulant Balla - Qeveria duhet të sjellë kërkesën dhe më pas ta shqyrtojmë me procedurë të përshpejtuar.

Arben Ahmetaj – Nuk besoj se është procedurë e përshpejtuar. Nuk ka pse të jetë

Gramoz Ruçi – Është depozituar, apo jo?

Mimoza Pano – Është depozituar, është njoftuar dhe është publikuar në faqen e Kuvendit, por nuk është përfshirë në program, sepse është një nga projektligjet që nuk plotëson kushtet që të futet automatikisht në program.

Mimi Kodheli – Moza, të lutem, cilin kusht?

Arben Ahmetaj – Është projektligji për disa shtesa në aktin normativ të ligjit nr. 4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare, ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta të mjeteve kryesore të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”. Këtë ka dërguar Sekretari i Përgjithshëm.

Gramoz Ruçi – Cilin kusht nuk plotëson? 2-javëshin?

Mimoza Pano – Jo, nuk plotëson kushtin që të futet automatikisht në program, sepse është depozituar pasi ne kemi miratuar programin aktual, i cili mbaron më 31 maj.

Gramoz Ruçi – Dakord.

Vazhdojmë.

Arben Ahmetaj – Kryetar, besoj se këtë radhë do të fusim ligjin për ndryshimet në koncesionet e partneritetit publik privat. Ramë dakord edhe me Kryeministrin.

Ndërkohë, në dijeninë time ka ardhur një PPP specifike për të kaluar në parlament dhe ne nuk kemi pse ta mbajmë...

Gramoz Ruçi - Mos ngatërrohi dy gjëra, e para.

Këtu nuk është programi, por kalendari. Ju po flisni për programin, por për të do të flitet kur të vijë koha.

Arben Ahmetaj – Kjo është çështje e kaluar. Po e them meqenëse nuk e kemi futur, sepse e kemi mbaruar para dy muajve si procedurë në komision.

Mimoza Pano – Është një projektligj që e kemi futur edhe në rend dite dhe me kërkesë e kemi lënë jashtë, nuk e kemi diskutuar. Projektligjin e kemi gati, komisionet kanë përgatitur raportet, por duhet vullnet për ta futur në rendin e ditës.

Gramoz Ruçi – Kush ka kërkuar të shtyhet?

Taulant Balla – Unë kam kërkuar të shtyhet. Kryeministri të japë porosi, nëse do, në qeveri. Këtu në parlament vendosim ne, kështu që ...

Arben Ahmetaj – Çfarë problemi ka kjo, jam kurioz të di.

Taulant Balla – Nuk është kjo, por nuk mund të vish këtu e të thuash “kam folur me Kryeministrin”.

Arben Ahmetaj – Ishte në mbledhje atë ditë.

Taulant Balla - Kryeministri jep porosi në qeveri, në Kuvend, unë, si sekretar grupi, kam kërkuar të shtyhet.

Arben Ahmetaj – Taulant, nuk mund të thuash “nuk dua unë”, sepse e kam dëgjuar disa herë këtë gjë. Kjo është çështje shumë e rëndësishme, pjesë e reformave...

Taulant Balla – Dakord.

Arben Ahmetaj – Të lutem, të mbaroj unë!

Kur thua “Nuk dua unë” duket sikur ti je pronar i grupit. Nuk silleni dot kështu. Ka ndonjë arsye që nuk do ti? Kryeministri e tha në grup, kur e ngrita unë. Ka ndonjë arsye specifike? Unë ndoshta nuk dua të fus PPP-në, që është 200 e ca milionë euro investim.

Taulant Balla – Do ta diskutoj dhe do të kthej përgjigje.

Arben Ahmetaj – Mos u sill sikur je pronar i grupit! Mos më kthe përgjigje mua!

Gramoz Ruçi – Ju lutem!

Arben Ahmetaj – Gramoz, të lutem, sepse e ka bërë disa herë!

Ka ndonjë arsye specifike kjo që nuk futet në program? Kjo mbyll ofertat e pakërkua një herë e mirë. Ka ndonjë arsye?

Gramoz Ruçi – Arsyeja është kjo: është tërhequr.

Arben Ahmetaj – Jo, nuk është tërhequr.

Gramoz Ruçi – Mos e merr kështu. Ti je pjesëtar i grupit. Kërkesa ka qenë në emër të grupit. Merruni vesh në emër të grupi, zgjidhni problemet e grupit dhe më pas...

Arben Ahmetaj – Jemi marrë.

Taulant Balla – Jo, nuk jemi marrë.

Gramoz Ruçi – Ju lutem!

Kryetari i grupit është këtu. E ka kërkuar ky të tërhiqet dhe duhet ta kërkojë ky që të futet.

Kaq e thjeshtë është.

Arben Ahmetaj – Gramoz, dakord, por nuk është tërhequr.

Gramoz Ruçi – Të lutem, fol me etikë!

E dyta, ti nuk përfaqëson në emër të grupit. Përfaqëson ...

Arben Ahmetaj – Jo, nuk dua ta përfaqësoj grupin.

Gramoz Ruçi – Ti ke punë vetëm me problemet e komisionit.

Të lutem!

Arben Ahmetaj – Kjo është çështje e komisionit, Gramoz!

Gramoz Ruçi – Është çështje e komisionit, por kjo nuk është mbledhje e komisionit. Komisioni ka mbaruar punë, e ka depozituar në seancë, ka qenë në rendin e ditës. Grupi parlamentar ka kërkuar heqjen e tij. Grupi parlamentar të kërkojë futjen e tij. Kaq.

Milva Ekonomi – Ka ngelur pa u miratuar edhe rezoluta e AMA-s për një ndryshim që u kërkuar në seancë, i cili u bë. Mbase vetëm për kujtesë është, sepse të gjitha të tjerat janë bërë.

Mimoza Pano – E kemi përfshirë në rendin e ditës së datës 16.

Taulant Balla – Data 16 është shënuar në kalendar.

Gramoz Ruçi – Tjetër.

Senida Mesi – Kam dy komente të vogla për draftrezolutën që kam parë te Departamenti i Administratës Publike. Ndoshta duhet ta adresoj me Ulsiun, sepse, në bazë të ligjit, është raport vjetor i Këshillit të Ministrave.

Në rezolutë thuhet “kudo rekomandohen ose i kërkojnë DAP-it”. Në fakt, duhet të jetë e kundërta, që Kuvendi i kërkon Këshillit të Ministrave për çështjet e Departamentit të Administratës Publike, jo DAP-i direkt, sepse DAP-i nuk raporton direkt në Kuvend, por te Këshilli i Ministrave, që të mos kemi problemin e AMA-s, që ta ndryshojmë në seancë dhe të zgjatet edhe një javë. Të bëjmë modifikimet. Do të flas edhe me Ulsin, që ta ketë merak gjatë aprovimit të rezolutës.

Nëse më lejon kryetari i komisionit ...

Taulant Balla – DAP-i raporton edhe në Kuvend.

Senida Mesi – Jo, me ligjin e Departamentit të Administratës Publike, raportin vjetor të DAP-it e aprovon Këshilli i Ministrave. Në ligj thuhet se Këshilli i Ministrave raporton në Kuvend. Këtu e kemi “Raporti vjetor i Këshillit të Ministrave për zbatimin vjetor të politikave të shërbimit civil”, ndaj në rezolutë duhet të jemi të kujdesshëm për të thënë se Kuvendi i rekomandon Këshillit të Ministrave pikat që kemi në rezolutë.

Taulant Balla – Kush ministër i mbulon?

Senida Mesi – Duhet të jetë zoti Braçe, sipas eksperiencës sime, sepse në administratën publike vazhdon të jetë zëvendëskryeministri. Thjesht duhet kujdes te rezoluta. Vasilika, besoj se e mbajtët shënim.

Vasilika Hysi – Po, e mbajta shënim.

Senida Mesi - Të rezoluta duhet të modifikojmë “DAP”-in me “Këshillin e Ministrave”, ku Kuvendi i kërkon Këshillit të Ministrave, jo DAP-it, sepse ne nuk i kërkojmë llogari DAP-it, por kemi komunikim me Këshillin e Ministrave.

Kryetari ndoshta më lejon, sepse bëhet fjalë për Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave. Shikoj pikën 6, një projektvendim për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe pikën dhe 13 për miratimin e strukturës dhe organikës dhe kategorizim të pozicioneve të punës të Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil. Mendoj se Komisioni i Ekonomisë dhe Financave duhet të jetë përgjegjës, siç është Komisioni për Çështjet e Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut, por për sa kohë që prek strukturën dhe buxhetin mendoj se duhet të kalojnë te komisioni ynë. Megjithatë, kjo ju takon juve të vendosni. Unë thashë një sugjerim.

Gramoz Ruçi – Dakord.

Mimoza Pano – Për sa i përket strukturës së institucioneve, kategorizimit të pagave, ne kemi ecur. Është ngritur edhe një herë në Konferencën e Kryetarëve ky diskutim me

komisionet përgjegjëse që mbulojnë ... Komisioni mbulon të gjitha aspektet, sepse merret mendimi me shkrim i Ministrisë së Financave dhe DAP-it për problematika.

Gramoz Ruçi – Tjetër?

Arben Ahmetaj – Kryetar.

Çështjet që kapin financat publike, Mimoza, nuk mund të shkojnë në komision tjetër. Unë e kam thënë disa herë, sepse kam parë tendencën dhe personalisht nuk dua t'ia di, le të shkojë ku të dojë, por logjika është që komisioni që bën buxhetin, vendos edhe për strukturën. Struktura ka konsekuencë financiare. Çfarë do të thotë do të shkojë te ligjet?

Mimoza Pano – Buxheti shqyrtohet edhe në komisionet përgjegjëse dhe i adresohet Komisionit të Ekonomisë ky propozim.

Arben Ahmetaj – Po, por në rastin konkret është çështje financiare.

Mimoza Pano – Kështu kemi vepruar deri tani.

Arben Ahmetaj – Mund të keni vepruar, por ndryshon.

Vasilika Hysi – E para, projektvendimi për një ndryshim është ndryshim strukture. Është organizimi dhe funksionimi i një institucioni të pavarur që raporton në Komisionin e Ligjeve, organ i të drejtave të njeriut. Ne do të diskutojmë aty, nuk flitet vetëm për paga, por për strukturën, organizimin, funksionet që ka struktura që ata kanë propozuar. E kemi pasur në kalendar para dy ditësh, por meqenëse komisioneri është me shërbim jashtë vendit e kemi shtyrë për ditën e hënë.

Pa dyshim, Ministria e Financave është e pranishme. Shërbimet e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit janë të pranishme, njëkohësisht edhe DAP-i. Kjo ka 10 vjet. Nëse ju mendoni se duhet bërë, ta bëjmë.

Arben Ahmetaj – Jo, mbajeni edhe 10 vjet të tjera.

Vasilika Hysi – Zoti Fino është relatori.

Milva Ekonomi – Për sa i përket ligjit për censusin e popullsisë dhe të banesave, unë po mendoja nëse mund të përfshihet edhe Komisioni i Edukimit dhe Informimit Publik për dhënie mendimi, sepse një pjesë e rëndësishme të indikatorëve të regjistrimit lidhen me objektivat e zhvillimit të ... (nuk dëgjohet). Ndërkohë, duhet ta shikojmë edhe ne.

Gramoz Ruçi – Tjetër.

Taulant Balla – Në projektkalendar kemi projektvendimin për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit.

Meqenëse të dy kryetarët e grupeve të opozitës tashmë kanë marrë detyrën e tyre, do të doja t'i informoja se me dy kryetarët e ish-grupeve parlamentare, LSI-së dhe PD-së kishim

nisur një punë për një reformim të thellë të Rregullores së Kuvendit, e cila merr inspirimin edhe nga rregulloret e institucioneve, siç është Parlamenti Europian, Bundestagu gjerman apo parlamente të tjera. Është bërë një punë e mirë dhe ka pasur konsensus pothuajse tërësor. Disa prej ndryshimeve në Rregullore kanë të bëjnë me një ndryshim në strukturimin e punës parlamentare, për t'u lënë më shumë hapësirë grupeve parlamentare për të punuar dhe më shumë hapësirë deputetëve për t'iu përkushtuar zonave të tyre zgjedhore. Kjo do të thotë se është planifikuar një mënyrë tjetër organizimi e seancave plenare. Pra, një ligj që diskutohet këtë javë nuk do të shkojë menjëherë të enjten në seancë, por të enjten pasardhëse, me qëllim që grupi parlamentar të ketë mundësi ta diskutojë dhe të jetë më i përgatitur për në seancë.

Po kështu, Rregullorja e Kuvendit ka pasur prej shumë vitesh një problematikë për mosadresimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që është një prej detyrave të shtëpisë ende të pa realizuara nga Kuvendi i Shqipërisë, në kuadër të përgatitjeve për marrjen e lajmit për fillimin e negociatave në qershor. Do të doja që të tre grupet parlamentare të përcaktonin tre apo gjashtë anëtarë, nga dy për secilin grup parlamentar, me qëllim që të uleshim për të diskutuar. Puna në komisione ka përfunduar, pra, nuk jemi në fazën që nuk është bërë puna paraprake, por sigurisht që në grupet tuaja duhet të bëhet një diskutim. Nëse doni, unë si iniciator, bashkë me Vasilikën dhe Ervin Bushatin, mund të vijmë pranë grupeve tuaja parlamentare për të bërë një prezantim për të kuptuar ku jemi. Nuk ka asnjë iniciativë për të ndryshuar aspektet kontrolluese të opozitës, por është bërë një punë në funksion të përmirësimit të jetës parlamentare të çdo deputeti. Kështu që, i kërkoj Vasilikës dhe Mozës që të dy kryeartëve të grupeve të opozitës t'u jepet nga një draft.

Ndërkohë, jemi në fazën që, përveç propozimeve që keni bërë deri më tani, duhen plotësuar edhe vendet vakante që i takojnë opozitës në Këshillin e Legjislacionit. Kujtojmë që maxhoranca dhe opozita në Këshillin e Legjislacionit janë të barabartë në numër anëtarësh, pesë me pesë. Po kështu, duhen plotësuar edhe pozicionet e tjera që i takojnë opozitës. Siç është bërë publike, opozita do të ketë të njëjtat pozicione që ka pasur më parë. Për Rregulloren dhe adresimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mendoj që do të ishte mirë t'i bënim brenda muajit ose dy javëve. Është e futur në kalendar në aspektin e respektimit të Rregullores, kështu që mund ta planifikojmë shqyrtimin në seancë plenare në datën 30. 05. 2019.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu mbaron përcaktimi i datës, sepse pa biseduar me ju, shërbimet e Kuvendit nuk mund ta përcaktojnë. Besoj se 21 ditë janë të mjaftueshme për të shqyrtuar një punë që është bërë. Ne kishim rënë dakord me grupet e atëhershme, por axhendat politike të ditës prevaluan mbi një punë që ...

Rudina Hajdari – Patjetër që na duhet pak kohë. Jam në dijeni për ndryshimin e Rregullores dhe me sa kam unë dijeni, disa nga institucionet që janë marrë me ju kanë disa problematika lidhur me këtë gjë.

Unë nuk jam anëtare në Komisionin e Ekonomisë, por janë disa projektligje të rëndësishme dhe projektligji për ofertat e pakërkuara, që ju keni tërhequr, është i rëndësishëm. Kështu që, është e udhës të na thoni se kur do ta diskutojmë, sepse me sa di unë duhet të miratohet para muajit korrik.

Vasilika Hysi - Duhet të ishte miratuar.

Rudina Hajdari – A është futur çështja e ndryshimit të aktit?

Vasilika Hysi - Jo

Rudina Hajdari – Dakord, sepse edhe ajo ka pasur problemet e saj. Mendoj se duhet parë me vëmendje. Duhet të jemi të kujdesshëm, sepse edhe ne si opozitë kemi rolin tonë. Ju keni shumicën dhe mund t'i bëni gjërat pa ne, por edhe ne nuk do të rrimë pa i ngritur këto shqetësime.

Nimet Musai – Faleminderit!

Na vjen mirë që Rregullorja është punuar dhe që do ta kalojmë brenda datës 30. Është në të mirën e Kuvendit dhe në të mirën tonë që gjithçka të ketë një ecuri normale. Jemi gati në çdo moment që do të lajmërohem nga kolegu dhe zonja Vasilika që jo vetëm t'i dëgjojmë, por edhe të bëjmë propozime nëse do të kemi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Janë dy momente: një problem e ka Këshilli i Legjislacionit për implementimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për paketën ligjore të reformës në drejtësi, gjë që pengon organet e ngritura, të cilat kanë mbetur pezull si rezultat i vakancës që u krijua në Këshillin e Legjislacionit. Puna është bërë, por duhet të mbahet një mbledhje ku kërkohet edhe prezenca e opozitës për të plotësuar kuorumin e Këshillit të Legjislacionit. Që ato të vijnë në sallën e parlamentit duhet të përfshihen në kalendar. Puna e bërë ka të bëjë me reformën në drejtësi dhe me plotësimin e të gjitha kërkesave që ka bërë BE-ja për këtë reformë që ne si Kuvend nuk kemi implementuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese në paketën ligjore të Reformës në Drejtësi.

Opozita duhet të dijë që Kuvendi, në zbatim të raportit të Komisionit European, ka përcaktuar 6 objektiva dhe 46 masa. Si rezultat i kësaj vakance, vetëm se nuk kemi implementuar këto vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe për shkak se nuk kemi bërë ndryshimet e Rregullores, rezultoi që gati 22 masa të përcaktuara nga Kuvendi në kuadrin e plotësimit të detyrimeve që Shqipëria ka, kanë ngelur pa u plotësuar ose raporti është pjesërisht

i plotësuar. Është shumë e domosdoshme që çështja të shikohet në këtë këndvështrim. Prandaj, ju lutem, të dyja këto çështje duhet të jenë objekt i shqyrtimit të këtij diskutimi dhe vendimmarrjes së Kuvendit në këtë kalendar.

Kjo kërkon arsyetim të situatës, plotësim të vakancave në Komisionin e Mandateve, plotësim të vakancave në Këshillin e Legjislacionit dhe njohja juaj me përmbajtjen e këtyre, sepse do të kërkohet vota juaj. Është mirë që ndryshimet në Rregullore të bëhen me konsensus.

Nimet Musaj – Faleminderit, Kryetar!

Do të mundohemi të plotësojmë që sot vakancat që kemi.

Taulant Balla – Besoj se jeni në dijeni për pozicionet që i takojnë opozitës, nga nënkryetari i Kuvendit deri te komisionet. Ju lutem, edhe delegacionet parlamentare.

Vasilika Hysi - Edhe kryetarët e komisioneve ku mungojnë.

Nimet Musaj - Zonja Moza na i ka vënë në dispozicion

Gramoz Ruçi – Moza, ju nxirrni vendet bosh për delegacionet siç i kanë pasur partitë politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kështu, edhe në komisione dhe Këshillin e Legjislacionit. Kurse për emrat është e drejtë të tyre të bëjnë propozimet.

Rudina Hajdari – Duke parë që vendet vakante po mbushen javë pas javë, duhet të ruajmë disa sepse nuk mund ..

Gramoz Ruçi – Kjo nuk do të thotë që të presim ...

(Diskutime pa mikrofon)

Në qoftë se në Këshillin e Legjislacionit ju takojnë pesë anëtarë, le të plotësohet me tre anëtarë tani ...

(Diskutime pa mikrofon)

Taulant Balla – Ky është sesioni i katërt. Sesionin tjetër, që fillon në shtator, në parim grupet parlamentare shikojnë shpërndarjen e deputetëve të tyre në secilin komision. Atëherë, ju, sikurse edhe ne, do të ribëjmë një rishikim të ...

Tani jemi në një fazë intensive. Muajt maj dhe qershor në Kuvend janë muaj të rëndësishëm.

Gramoz Ruçi – Ka gjë tjetër?

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

